

20 rregulla për të bërë pazarin që të mbrojmë shëndetin e të gjithëve

Të bashkëpunojmë për të mposhtur Coronavirus

Përpara se të nisemi nga shtëpia



Beje listen e shpenzimeve të domosdoshme duke verifikuar hapësirën në dispozicion në shtëpi (në frigorifer, në dispensë dhe në garazh,...).



Evito të shkosh të bësh pazarin në oraret me fluks të lartë dhe zgjidh ditët dhe oraret më pak të frekuentuara.



Përpiqu ti përqëndrosh të gjitha blerjet në të njëjtin moment, prandaj organizohu që të bësh pazarin me sa me pak frekuencë të jetë e mundur.



Nëse në shtëpi keni dizinfektues për duart merr me vete.



Nëse është e mundur drejtohu në pikat e shitjeve që njihni më mirë dhe që përvetësoni më mire se si janë të sistemuara produktet në supermarket.



Nëse në momentin e ardhjes tek supermarketi vë re se ka shumë persona dhe ti ke mundësinë që ta shtysh tregtimin në një orar më pak të frekuentuar, shtyje pazarin me tutje.



Nëse është e mundur shko të bësh pazarin vetëm, jo i shoqëruar me fëmijë dhe të moshuar.

Në supermarket



Lexo me vëmendje udhëzimet që janë vendosur në pikat e shitjeve dhe zbatohu në mënyrë rigorozë çdo gjë të sugjeruar nga ata.




Edhe në hyrje të supermarketit kujtohu që të mos qëndrosh i ndaluar për të folur me personat e tjerë.




Dizinfekto duart përpara se të hysh në supermarket.




Në kasë poziciono ushqimet në rripin e banakut dhe kalo shpejt pa qëndruar i ndaluar përpara shitëses.



Ndiq listen që ke përparuar për blerjet e tua dhe prit radhën me distancë të paktën një metër, në mënyrë që klientët e tjerë të kenë marrë produktet nga raftet e supermarketit, përpara se edhe ti ti drejtohesh rafteve për të marrë produktet që të shërbejnë.




Për të paguar nëse është e mundur zgjidh bankomat dhe kartë kreditit.



Edhe kur je tek shërbimi me numër, tek kasa apo peshoret, kushtoi vëmendje të veçantë të presësh radhën tënde sipas distancës së sigurisë.



Pasi të kesh paguar vendos pazarin në karrocë, pasi do të kesh mundësi ta vendosësh në qese me qetësi pasi të kesh dalë jashtë në parkim, në ajër të pastë, përpara se ta vendosësh në makinë.



Kur je tek kasa apo shërbimi me numër, mbaj distancë me operatorin që të shërben, të pakten sa është distanca mes krahut të shtrirë të të dyve.

Pasi të kesh bërë pazarin



Paketo me qetësi pazarin në çantat e pazarit, jashtë supermarketit në ajër të pastër.



Në rastin kur ke bërë pazarin për një të afërm apo një person që njihni, përpiqu të minimizosh mundësinë e kontaktit në momentin e dorëzimit të pazarit.



Sapo të mundësh vendos pazarin në hapësirat që ke për pazarin në shtëpi (në frigorifer, dispensë apo garazh) dhe laj ose dizinfekto përsëri duart.